



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHIJEVE

Nr 6 Prot

Datë, 19 / 11 / 2018

VENDIM

“Për përcaktimin e kriterëve për kandidim për anëtar të Senatit Akademik”

Bazuar në ligjin nr. 8485, dt. 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 131 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, urdhrin e Rektorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike Nr. 339 Prot, dt. 16.11.2018, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës, 19.11.2018,

VENDOSI

Miratimin me unanimet të plotë të kriterëve që duhet të plotësojë një kandidat për anëtar të Senatit Akademik, si më poshtë vijon:

1. Dokumentacioni për kandidim nga kandidatët dorëzohet në KIZ dhe përmban:
 - a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë, shprehjen e vullnetit për kandidim, deklarin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion, deklarin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale, deklarin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
 - b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
 - c) Kopje të noterizuar të titullit akademik;
 - d) Dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar.
2. Formular aplikimi.
3. Formular vetëdeklarimi.

KRYETAR

Z. Ervin Kaçi

Z. Hasan Bello



Z. Elio Hobdari

Znj. Rafaela Marteta

SEKRETARË
Marsela Drita